REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY
QENDRA PËR SHËRBIME QYTETARE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS
SH./Z. /S. 02 Nr./Br./No. 6043
Nr Fq. / Br Str / No Pg 1
Data / Datum / Date 09/03/26
KAMENICË - KAMENICA

**Komisioni Komunal për inicimin dhe ndihmën ndaj pronarëve të ndërtesave në bashkëpronësi, për krijimin e Shoqatave të Pronarëve**

# N J O F T I M

Në bazë të Vendimit Sh.02 Nr.2367 të dates 27.01.2026, Zyra e Kryetarit të Komunës së Kamenicës, ka formuar Komisionin Komunal për inicimin dhe ndihmën ndaj pronarëve të ndërtesave në bashkëpronësi, për krijimin e Shoqatave të Pronarëve.

Shoqata e Pronarëve – është Autoritet ligjor që funksionon si organizatë joqeveritare ose person juridik, ku obligohen të anëtarësohen të gjithë pronarët e njësive individuale të ndërtesës në bashkëpronësi.

Ky Njoftim bëhet për të informuar pronarët e njësive individuale lidhur me:

- Procesin e themelimit të Shoqatës së Pronarëve;
- Organizimin dhe funksionimin e bashkëpronësisë;
- Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të përbashkëta (hyrjet dhe korridoret e ndërtesës, shkallët dhe ashensorët, kulmin dhe fasadën e ndërtesës, zonat e parkimit, hapësirat e gjelbërta dhe rekreative, instalimet e pëbashkëta të ndërtesës etj).

Komisioni Komunal do të organizojë takime informuese me pronarët e njësive individuale të ndërtesave në bashkëpronësi, për të ndihmuar në procesin e krijimit të Shoqatës së Pronarëve dhe Kryesinë e Shoqatës, për të cilin proces kërkojmë bashkëpunim nga ana e juaj.

Për informata plotësuese në lidhje me ketë proces, ju lutem na shkruani në e-mail: durim.biqkaj@rks-gov.net.

**Datë: 09.03.2026**

**Durim Biqkaj**

**Kryesues i Komisionit Komunal**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA
02 KRYETARI I KOMUNËS - PREDSEDNIK OPŠTINE